



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1588/4 Prot

Datë 08.08.2022

**V E N D I M**

**Nr. 759/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.08.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt Loti 1 “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me fond limit 28,918,530 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

Mbyllja e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

“Infosoft Office” SHPK  
Autostrada Tiranë-Durrës, km.8, Kashar, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Posta Shqiptare SHA.  
Rruga Reshit Çollaku, nr.4 Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë  
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.07.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me fond limit 28,918,530 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

II.2. Në datën 21.07.2022 operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, ka paraqitur ankesë me nr. 1588 prot, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr1637/13 prot., datë 02.08.2022 protokolluar me tonën me nr. 1588/2 prot., datë 04.08.2022, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office ” SHPK “ *Në DT në pikën 2.10 përshkrimi i shkurtër i kontratës AK është shprehur: Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj shumatorja e çmimeve për njësi është 62,891,062 lekë pa TVSh. Pra AK është shprehur për shumatore nëse ka disa artikuj. Duke marrë parasysh se kjo procedurë prokurimi ka më shumë se një artikull shumatorja na konfuzon, aq më tepër që është me e lartë se fondi limit i përcaktuar. Kërkojmë shpjegimin dhe saktësimin e kësaj pike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

- *Dokumentet e tenderit janë hartuar në përputhje me setin e dokumenteve të paraqitura dhe të miratuara nga APP. Referuar faktit që procedura është me lote gjatë hedhjes së të dhënave të procedurës në SPE vetë sistemi i prokurimit të detyron të hedhësh vlerën e plotë të të gjithë procedurës dhe më pas të vazhdohet me lotet. Në DT dhe në njoftimin e kontratës është mjaft e qartë vlera totale limit e prokurimit si dhe vlera limit e secilit lot të kësaj procedure.*

III.1.2. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi në pikën 2.10 përshkrimi i shkurtër i kontratës përcaktohet si më poshtë:

### **2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **Monedha, pa TVSH.**
2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është 62,891,062** (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) **Lekë, pa TVSH** \_

**Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me vlerë 28,918,530 (njëzet e tetë milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) Lekë, pa TVSH.**

**Loti i II-të “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me vlerë 33,972,532 (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) Lekë, pa TVSH**

III.1.3. Në dokumentet standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik përcaktohet si më poshtë:

### **2.8 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër**

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës \_\_\_\_\_
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** \_\_\_\_\_
3. Burimi i Financimit \_\_\_\_\_
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër \_\_\_\_\_

III.1.4. Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se :

*Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet

*ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

*3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

Referuar sa më lart, nga krahasimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe setit standard të dokumenteve të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk ka plotësuar në përputhje të plotë me setin standard të dokumenteve të tenderit pikën 2.10 përshkrimi i shkurtër i kontratës të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Konkretisht autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka përcaktuar në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është 62,891,062, kur në fakt vlera 62,891,062 është vlera totale e fondit limit për të dyja lotet dhe jo shumatorja e çmimeve për njësi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin dhe saktësimin e kësaj pikë duke përcaktuar vlerën e fondit limit në pikën 1 të seksionit 2.10 dhe në pikën 2 të vendosë vlerën e saktë të shumatores së çmimeve për njësi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office ” SHPK “*Në DT kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar*2.3.6 *Operatori ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra /modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK (një kuti me pesë rizma letër fotokopje A4 dhe një rizëm me 500 fije xletër fotokopje A3). Pra AK kërkon mostër edhe për artikullin letër A3 megjithëse është në sasi shumë të vogël. Përmendim që letra është e njëjtë si A4 , ndryshon vetëm formati prandaj është e ekzagjeruar kërkesa për mostër të këtij artikulli. Për artikullin Letër A4 kërkohet mostër 1 kuti që peshon rreth 12.5 kg ndërkohë që njësia e kërkuar në tender është kg. Mendojmë që është e ekzagjeruar kërkesa për 1 kuti mostër ndërkohë që paketimi bazë është 1 rismë me 2.5 kg. Ju lutem korrigjoni. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

*2.3.6 Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas*

specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (**një Kutë me pesë rizma Letër fotokopje A4 dhe një rizëm me 500fije x Letër fotokopje A3**).

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim."

III.2.2. Në shtojcën 6 "Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti i Parë: "Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3",

<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia e kërkuar</i>
<i>1</i>	<i>Leter fotokopje A4</i>	<i>kg</i>	<i>130,000</i>
<i>2</i>	<i>Letër fotokopje A3</i>	<i>Kuti</i>	<i>5</i>

III.2.3. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

Paraqitja e mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e dorëzuara do të testohen edhe në pajisjen e printimit të filialit hibrid mail. Pretendimi që kërkohet si kampion një kuti ndërkohë që njësia e kërkuar në tender është kg nuk qëndron për faktin se në specifikimet teknike janë detajuar pesha dhe numri i faqeve për një rizëm.

III.2.4. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.2.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.8. Neni 40 pika 6 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht se:

- Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
  - a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit

*administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

- *b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- *c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.9. Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se :

- *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*
- *2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*
- *3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

III.2.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.



Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik. Operatori ekonomik ankimues, kërkon modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e mostrave për letrën A3. KPP vëren, se sasia e kërkuar e letrës A3 në procedurën e prokurimit objekt-ankimi është e vogël (5 kuti). Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret duhet të kërkojë mostra vetëm për letrën A4 e cila është në sasi relativisht të lartë ndërsa për letrën A3 në vlerësimin e Komisionit kërkimi i mostrës nuk është në proporcion me vlerën dhe përmasat e kontratës. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit lidhur me paraqitjen e mostrës duke e kufizuar kërkesën e tij vetëm sa i takon letrës A4.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e ankimuesit: *Mendojmë që është e ekzagjeruar kërkesa për 1 kuti mostër ndërkohë që paketimi bazë është 1 rismë me 2.5 kg. Ju lutem korrigjoni*, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të saktësojë njësinë matëse në mënyrë që ajo të jetë e njëjtë në të gjitha përcaktimet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi me qëllim shmangien e konfuzionit në radhët e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office ” SHPK “ *Në DT tek shtojcë 5 specifikimet teknike për produktin letër fotokopje A4+A3 është kërkuar: Letër fotokopje A4 cilësi e parë me certifikatë ISO, letër fotokopje A3 me certifikatë ISO. Gjykojmë se ky është një specifikim i papërcaktuar mirë pasi mund të shkaktojë konfuzion tek OE ofertues. Kërkojmë që ky kriter të modifikohet pasi termi cilësi e parë është evaziv dhe lë vend për interpretim. AK e ka përcaktuar cilësinë e letrës në specifikime teknike. Kërkojmë që AK të përcaktojë llojin e certifikatës ISO, dhe “Në DT kriteret e veçanta kërkohet certifikatë ISO 9001:2015, 14001:2015, 45001:2018. Duke qenë se vetëm për ISO 45001:2018 është përcaktuar që kërkohet për kompaninë ju lutem specifikoni nëse edhe dy Isot e tjera kërkohen gjithashtu për kompaninë (OE), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimet sa më sipër sqarohet se:

- *Me qëllim shmangien e çdo konfuzioni për OE e interesuar bëhen sqarimet dhe modifikimet përkatëse. Pretendimi juaj vlerësohet e drejtë.*

*Letër fotokopje A4*

*Bëhet*

*Cilësi e parë me certifikatë ISO 9706:1994*

*Letër fotokopje A3*

*Bëhet*

*Cilësi e parë me certifikatë ISO 9706:1994*

- *Ju sqarojmë se në DT për përmbushjen e këtij kriteri kërkohet që të tre ISOT të jenë të operatorit ofertues. Pretendimi vlerësohet i drejtë.*

III.3.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.3.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Sa më sipër, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e sipërcituara të të pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office ” SHPK “*Në vijim po në shtojcën 5 specifikimet teknike vëmë re se specifikimet janë shumë të ekzagjeruara si më poshtë:*

*Një pjesë e tyre nuk përfshihen në skemat teknike të prodhuesve dhe nuk ndikojnë aspak në performancën e letrës si:*

*Ashpërsia në përkulje MD>110 mN*

*Ashpërsia në përkulje CD>50mN*

*Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min*

*Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min*

*AK nuk e ka argumentuar nevojën se përse letra duhet të kufizohet në parametrat e mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.4.1. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

#### ***I. Letër fotokopje A4***

- *Cilësi e parë me certifikatë ISO*
- *Gramatura nominale, 80gr/m<sup>2</sup> dhe një rizëm (500fije x A4)*
- *Përmasat: 210 x 297 mm*
- *Pesha bazë 80gr/m<sup>2</sup>*
- *Lagështira: 3.0 - 4.0%*
- *Trashësia : 103-110 µm*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min*
- *Ashpërsia në përkulje:MD >110mN*
- *Ashpërsia në përkulje:CD >50mN*
- *Patejdukshmëria >94%*
- *Shkëlqimi: 108 - 111%*
- *Bardhësia CIE 161-165*
- *Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 rizma*
  - *Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in*
  - *Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit*
  - *Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit*
  - *Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët*
  - *Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkiv*
  - *Të mos jetë e ricikluar*

## **II. Letër fotokopje A3**

- *Cilësi e parë me certifikatë ISO*
- *Gramatura nominale, 80gr/m<sup>2</sup> dhe një rizëm (500fije x A3)*
- *Përmasat: 297 X 420 mm*
- *Pesha bazë 80gr/m<sup>2</sup>*
- *Lagështira: 3.0 - 4.0%*
- *Trashësia : 103-110 µm*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min*
- *Ashpërsia në përkulje: MD >110mN*
- *Ashpërsia në përkulje: CD >50mN*
- *Patejdukshmëria >94%*
- *Shkëlqimi: 108 - 111%*
- *Bardhësia CIE 161-165*
- *Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 rizma*
  - *Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in*
  - *Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit*
  - *Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit*
  - *Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët*
  - *Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkiv*
  - *Të mos jetë e ricikluar*

III.4.2. Referuar kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se:

*AK ka argumentuar rëndësinë e realizimit të këtij prokurimi dhe furnizimin e letrës të cilësisë së parë pasi pajisja Hibrid mail që ne përdorim për shërbime printimi është një pajisje mjaft specifike dhe nëse cila e letrës nuk është në standardet e kërkuara si dhe nëse është sadopak e përthyer apo e dëmtuar nuk realizon shërbimin e printimit. Kjo e sqaruar edhe në procesverbalin e argumentimit të kritereve të publikuar në SPE. Vendosija e këtyre specifikimeve nuk i referohet aspak një marke të caktuar por lejon tolerancë të mjaftueshme për larmi produktesh por gjithmonë kërkohet produkt i një cilësie të mirë.*

III.4.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet*

*operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.4 Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.4.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.4.6. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ përcaktohet se:

*“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

c) *kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

6. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik.

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit..

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.4.9. Referuar sa më sipër, KPP vëren se ankimuesi në parashtrimet në ankesë pretendon se specifikimet teknike lidhur me *Ashpërsia në përkulje MD>110 mN Ashpërsia në përkulje CD>50mN Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min* janë diskriminuese. Ndërkohë ankimuesi përveç deklarimeve të tij nuk argumenton në asnjë moment se si këto specifikime teknike çojnë drejt një prodhuesi apo një numri të ulët prodhuesish të cilët mund të plotësojnë këto specifikime. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor argumenton se: *AK ka argumentuar rëndësinë e realizimit të këtij prokurimi dhe furnizimin e letrës të cilësisë së parë pasi pajisja Hibrid mail që ne përdorim për shërbime printimi është një pajisje mjaft specifike dhe nëse cila e letrës nuk është në standardet e kërkuara si dhe nëse është sadopak e përthyer apo e dëmtuar nuk realizon shërbimin e printimit. Kjo e sqaruar edhe në procesverbalin e argumentimit të kritereve të publikuar në SPE. Vendosja e këtyre specifikimeve*



*nuk i referohet aspak një marke të caktuar por lejon tolerancë të mjaftueshme për larmi produktesh por gjithmonë kërkohet produkt i një cilësie të mirë.* Komisioni duke marrë parasysh parashtrimet në ankesë të ankimuesit dhe argumenteve të sjella nga autoriteti kontraktor gjykon, se specifikimet teknike për artikullin objekt-prokurimi janë përcaktuar me diapazon në përputhje me frymën e ligjit, i cili përcakton se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. KPP sqaron, se fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. Në rastin konkret ankimuesi nuk argumenton se specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, kufizojnë konkurrencën dhe përbëjnë element diskriminues apo akoma më tej këto përcaktime drejtojnë drejt një prodhuesi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt Loti 1 “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me fond limit 28,918,530 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 15.08.2022, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**